

FSE-IZI, AZNA, OUTGOING  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT OF KOSOVA  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administracije  
Ministry of Local Government Administration  
Nr.  
Etr.  
No. 0203-819/1  
Data  
Datum  
Date 30.07.2012



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Prishtinë, Datë: 27.07.2012

Nr.0203-819

**Arben Çitaku**  
Sekretar i Përgjithshëm  
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

**Lënda:** Shkresë përcjellëse

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar **kërkesën** për interpretim ligjor të Rregullores mbi kriteret dhe procedurën për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje nga Komuna e Vushtrrisë.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë me Nr. 2/119 të datës 07.04.2010 për formimin e komisioneve për shqyrtimin e akteve lokale, ju si ministri Kryesuese e Komisionit, po ju përcjellim për shqyrtim dhe vlerësim të ligjshmërisë Kërkesën për interpretim ligjor.

Bashkangjitur gjeni Kërkesën për interpretim ligjor të Rregullores mbi kriteret dhe procedurën për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje nga Komuna e Vushtrrisë.

Me respekt,  
**Besnik Osmani,**  
Sekretar i Përgjithshëm,  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Kopje: Xhemail Metolli-MMPH  
Naime Pakashtica -MMPH  
Hanife Alimusaj -MAPL  
Arkivit të MAPL-së



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Priština, Datum: 27.07.2012

Br.0203-819

**Arben Çitaku**

Generalni sekretar

Ministarstvo sredine i prostornog planiranja

**Predmet:** Propratni dopis

Poštovani

Ministarstvo administracije lokalne samouprave primilo je zahtev o pravnom tumačenju Uredbe o kriterijumima i procedurama legalizacije izgrađenih objekata bez dozvole, od strane opštine Vuçitrn..

Prema odluci Vlade Br. 2/119 dana 07.04.2010 o fomiranju komisije za razmatranje lokalnih akata, Vama kao predsedavajuće Ministarstvo komisije dostavljamo na razmatranje i procenu zakonitosti zahtev o pravnom tumačenju .

Uz prilog možete naći zahtev o pravnom tumačenju uredbe o kriterijumima i procedurama za legalizaciju izgrađenih objekta bez dozvole opštine Vuçitrn.

Sa poštovanjem,

**Besnik Osmani,**

Generalni sekretar,

Ministarstvo administacije lokalne samouprave

Kopija: Xhemail Metolli-MSPP

Naime Pakashtica -MSPP

Hanife Alim usaj -MALS

Arhivi MALS-a



2934  
15-22-2012



**REPUBLIKA E KOSOVËS- KOMUNA VUSHTRRI**

<b>DATE/A</b>	18.07.2012
<b>REFERENC-Ë:</b>	08Nr.68
<b>PËR/ZA/TO:</b>	<b>Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal Prishtinë</b>
<b>CC:</b>	<b>Departamentin Ligjor z.Agron Maxhuni</b>
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH</b>	<b>Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit</b>
<b>NGA/OD/FROM:</b>	<b>Idriz Ismajli-Drejtori i drejtorisë Ilirjana Azemi-Zyrtare ligjore</b>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Kërkesë lidhur me Interpretimin ligjor të Rregullores mbi kriteret dhe procedurën për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje</b>

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministrstvo Lokalne Samouprave i Administracije  
Ministry of Local Government Administration

Tirë  
Datum: 19.07.2012  
Data:

Shënimet	Pr. Llogarit	Shënimet	Vlera

**I nderuar,**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka pranuar një numër të madh të kërkesave për legalizimin e objekteve kolektive dhe individuale në Komunën e Vushtrrisë.

Në mungesë të legjislacionit pra Ligjit për Legalizimin dhe akteve tjera ligjore që të veprohet në çështjen përkatëse që ka të bëjë konkretisht me legalizimet e objekteve kërkojmë nga ju interpretim ligjor të Rregullores mbi kriteret dhe procedurën për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje 01Nr.256 të datës:27.06.202 të aprovuar nga Kuvendi Komunal në Vushtri për arsye që lëndët mos të mbesin në procedurë si dhe mos t'u kaloj afati ligjor.

Të bashkangjitur keni Rregulloren mbi kriteret dhe procedurën për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje si dhe Vendimin për ndryshimin e Rregullores mbi kriteret dhe procedurën për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje 01Nr545/03 të datës 09.07.2003,Vendimin për ndryshimin e Rregullores mbi kriteret dhe procedurën për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje01Nr716/04 të datës 29.09.2004.



**KUVENDI KOMUNAL-VUSHTRRI**

---

KOMUNA E VUSHTRRIË - KOSOVË  
MUNICIPALITY OF VUSHTRRI - KOSOVA  
OPŠTINA VUČITRN - KOSOVO

01 No: 256 dt. 27.06.2002  
VUSHTRRI

**RREGULLORE  
MBI KRITERET DHE PROCEDURËN PËR LEGALIZIMIN E  
OBJEKTEVE TË NDËRTUARA PA LEJE**

**Qershor 2002**

Në bazë të nenit 4 të Rregullorës mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr.2000/45-UNMIK, nenit 4 të Rregullorës mbi ndërtimin në Kosovë nr.2000/53 UNMIK dhe nenit 27 Statutit të Komunës së Vushtrris, Kuvendi i Komunës Vushtrri, në mbledhjen e mbajtur me datën 27.06. 2002.nxjerrë :

## **R R E G U L L O R E** **MBI KRITERET DHE PROCEDURËN PËR LEGALIZIMIN E** **OBJEKTEVE TË NDËRTUARA PA LEJE**

### **Neni 1.**

Me këtë Rregullore caktohen kriteret për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi në Komunën e Vushtrris, fazat e punës në procesin e legalizimit dhe formimi i komisionit për rastet e veqanta.

### **Neni 2.**

#### **Kriteret në bazë të të cilave objektet e ndërtuara pa leje ndërtimi nuk mund të legalizohen**

1. Nuk mund të i nënshtrohet procesit të legalizimit, objekti i cili nga organet kompetente konstatohet se është i ndërtuar në pronësi shtetërore ose pronari nuk mund të prezentojë prova se ka të drejtën e posedimit në ngastrën ku është ndërtuar objekti pa leje.
2. Nuk mund të legalizohet objekti i ndërtuar pa leje ndërtimi, në ngastrën kadastrale ku sipas planeve detale të aprovuara-në fuqi si dhe PPU parashifet rrugë e rëndësishme apo ndonjë object kapital, dmth. Ato objekte pamundësojnë zhvillimin e infrastructures të qytetit.
3. Nuk mund të legalizohen objektet e ndërtuara pa leje që paraqesin rrezik për sigurin publike dhe shëndetin e njeriut.
4. Nuk do të bëhet legalizimi i objekteve të cilat filloj së ndërtuari pas aprovimit të kësaj rregulloreje.

### **Neni 3.**

#### **Kriteret të cilat duhen të plotsohen me rastin e legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimore**

1. Mundësia e legalizimit është për objektet të cilat janë ndërtuar në ngastrën ku pronari prezenton prova të mjaftushme se është pronar i saj (kushti themelor).
2. Mund të legalizohet objekti i ndërtuar pa leje nëse konstatohet se nuk është bërë thyrrja e vijës ndërtimore dhe se e njejta nuk kalon në sipërfaqen e koridorit të profilit të rrugës që është parapa sipas PPU-apo të ndonjë objekti kapital e të ngjajshëm.

Rregullore legalizim I

3. Mund të bëhet legalizimi i objekteve që i përmbushin kushtet hapsinore urbanistike sipas planeve detale në fuqi kurse në zonat ku nuk ka plane detale dotë jetë i mundëshëm etazhiteti maksimal: P+3+NK.
4. Mund të bëhet legalizimi i objekteve të mbindërtuara në objektet egzistuese pasi që të rregullohet qështja e pronësis në rast kur Instituti përkatës professional jep prova të mjaftushme se ekziston një mundësi e tillë.
5. Mund të legalizohet objekti i ndërtuar në zonat ku nuk është i parapar për ndërtim individual sipas PPU – në ato raste kur konstatohet se potezi është atakuar aq shumë nga ndërtimet pa leje ndërtimi sa çdo intervenim tjetër është i pa arësyeshëm.
6. Mund të bëhet edhe legalizimi I përkohëshëm I objekteve të ndërtuara pa leje para hyrjesë në fuqi të kësaj rregullorjeje me kushtë që në aktin mbi lejen ndërtimore të ceket se investitori është I obliguar që me shpenzimet e vetadhe pa kompenzim ta rrënoj objektin në momentin kur ngastrës në të cilën është I ndërtuar objekti I bëhet qasje për realizimin e destinimit sipas planeve urbanistike

#### Neni 4.

Për rastet për të cilatorgani competent komunal për leje ndërtimore e vlerëson se janë shumë të ndërlikuara , mund të kërkoj nga Bordi I Drejtorëve të K.K.-ës Vushtrri që të formojë një komisionë të posaqëm për të vendosur lidhur me ato kërkesa.

#### Neni 5

Legalizimi I objekteve të ndëruara pa leje ndërtimore do të bëhet në afatin prej 3 muajve, prej ditës së aprovimit të kësaj rregullorjeje pa dënim për mos respektim të procedurës ligjore. Pas këtij afati investitori do të paguaj gjobën prej 500€ në llogari të Komunës së Vushtrrisë për mos legalizimin me kohë të objektit të ndërtuar .

#### Neni 6.

Për zbatimin e kësaj Rregullorjeje obligohen Drejtorija për zhvillim territorial – Sektori për planifikim dhe shfrytëzimin e tokës, dhe Drejtoria për punët e Inspektionit.

#### Neni .7

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit Komunal në Vushtrri.

O1 Nr. 0256

11.07.2002



Rregullore legalizim 2